



Macedonian Young Lawyers Association

**THIRRJE për gazetarë dhe fotoreporterë për pjesëmarrje në punëtorime temë
“Raportim për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe personave pa shtetësi” pas
së cilës do të vijojë një cikël grantesh**

Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinjë në bashkëpunim me Komesariatit të Lartë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë – UNHCR shpall thirrje për pjesëmarrje në puntorinë “Raportim për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe personave pa shtetësi” e cila do të pasohet me dhënie të granteve për gazetarë dhe fotoreporter. Punëtoria organizohet me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të punëtorëve mediatik në temat siç janë: mbrojtja e refugjatëve dhe azilkërkuesve, integrimin e tyre dhe ç`rrënjosjen e pashtetësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qëllimi përfundimtar i punëtorisë dhe granteve është të mbeshtesë gazetarinë profesionale cila i informon qytetarët mbi temat për mbrojtjen e refugjatëve dhe azilkërkuesve, integrimin e tyre dhe ç`rrënjosjen e pashtetësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kjo thirrje për pjesëmarrje në punëtori dhe dhënie të granteve zbatohet në kuadër të projektit “Përfaqësim dhe ndihmë juridike të personave të cilët bien nën mandatin e UNHCR dhe parandalimin dhe uljen e pashtetësisë”.

Thirrja është e hapur për të gjithë gazetarët, fotoreporterët, redaktorët dhe punëtorët e përgjithshëm mediatik të cilët raportojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe krijojnë video lajme, raporte të shkruara (në media të shkurara dhe në internet), animacione, storie grafike, fotostorie dhe forma të tjera vizuale të raportimit në media dixhitale.

Çdo punonjës mediatik që do të merrë pjesë në punëtori do të ketë mundësinë të aplikon për grant në ciklin për dhëniene granteve. Të gjitha detajet në lidhje me ciklin për dhëniene e granteve do të komunikohen gjatë punëtorisë.

Detaje rreth Punëtorisë „Raportim për mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe personave pa shtetësi“

Vendi dhe koha

Punëtorja do të organizohet më 30.10.2020 (e premte), prej orës 09.30 deri më ora 13.30. Të gjithë aplikantëve do t`u dërgohet linknga platforma dixhitale në të cilën do të realizohet punëtorja.

Regjistrimi për pjesëmarrje në punëtori

Formularët për regjistrim janë të disponueshëm për tu shkarkuar në: www.myla.org.mk

Formularët e plotësuar për regjistrim në punëtorinë dorëzohen në mënyrë elektronikë në: contact@myla.org.mk

Afati i fundit për aplikim: 27.10.2020 deri më ora 16:00.